



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:274345  
Datë: 11.12.2024  
Numri i dokumentit: 06582018

C-IV-17-0352

Parashtruesi i ankesës; R Sh nga Prishtina, përfaqësuar nga avokati Sh L nga Prishtina.

Kundër palës kundërshtare: Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga Dritan Hoxha nr.55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit Asllan Krasniqi, me datën; 11.12.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

1. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e parashtruar nga R Sh vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj vendimi me shkrim me numër PEJ002-0010, i datës 30.05.2017, i lëshuar nga AKP.
2. Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me datën 05.07.2017, pranë DHPGJS, është parashtruar ankesë nga R Sh kundër palës kundërshtare Agjencisë Kosovare të Privatizimit lidhur vendimit me shkrim që evidentohet me numër PEJ002-010, të lëshuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e tij me të cilën ka kërkuar kompensimin në emër të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe kontributet pensionale në shumën prej 47,213.40 din nga Autoriteti i Likuidimit i NSH APIKO (në likuidim).

Parashtruesi i ankesës në ankesën e parashtruar ndër të tjera ka theksuar se pranë Autoritetit të Likuidimit ka parashtruar kërkesë kreditore për kompensim në emër të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe kompensimin e kontributeve pensionale, pasi që Autoriteti i Likuidimit kërkesën kreditore e ka refuzuar si të pa bazuar.

Ka pretenduar se vendimi i Autoritetit të Likuidimit është nxjerrë në shkelje esenciale të prezumimeve procedurale; aplikim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të

dispozitive materiale juridike. Në lidhje me shkeljen e prezumimeve procedurale ka theksuar se vendimi i AL-së nuk përmban arsyetimin dhe se ky vendim është në kundërshtim me Ligjin për Procedurën Administrative. Në lidhje me konstatimin e gabuar të gjendjes faktike ka theksuar se ankesa e parashtruar është e afatshme se e vetmja mënyrë e realizimit të shumave të kërkuara ka qenë me fillimin e procedurës së likuidimit të ndërmarrjes. Ndërsa sa i përket zbatimit të gabuar të dispozitave materiale juridike e ka kundërshtuar zbatimin e dispozitave të LMD-së, ngase ka pretenduar se duhet zbatuar Ligjin për AKP-në. Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që pas shqyrtimit të provave të lëndës ankesën e parashtruar ta aprovoj në tërësi si të bazuar dhe me aktgjykim ta anuloj vendimin e AL-së dhe ta detyroj palën kundërshtare kompensimin e shumës së kërkuar.

Kësaj ankese parashtruesi si provë i ka bashkëngjitur:

- *Vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PEJ002-0010, me të cilin është refuzuar kërkesa për kompensim në emër të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes para kohe të marrëdhënies së punës në Ndërmarrje;*
- *Vendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë të datës 25.11.1996;*
- *Pasqyrën e borxhit të ndërmarrjes;*
- *Kërkesën e parashtruar nga parashtruesi i anekses të datës 03.10.2005;*
- *Kërkesën e datës 12.06.2014.*

Me datën 01.08.2017, AKP-ja përmes përfaqësuesit të sajë ka paraqitur mbrojtjen e saj ndaj ankesës së parashtruar nga R Sh ku ndër të tjera ka theksuar se NSH APIKO(në likuidim), ka hyrë në procedurën e likuidimit me datën 22.02.2017. Me datën 20.04.2017, parashtruesi i ankesës ka parashtruar një kërkesë, me të cilën ka kërkuar kompensim në emër të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes para kohe të marrëdhënies së punës, kompensimin e pagave të pa paguara dhe kontributet pensionale në shumën prej 47,312.40 dinarë. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga i njëjti në atë procedurë dhe me vendimin me numër PEJ002-0010, kërkesën e parashtruar nga parashtruesi i ankesës e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar.

Me tutje në mbrojtjen e parashtruar ka theksuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe drejtë ka zbatuar edhe dispozitat ligjore. Rregulla bazike e procedurës kontestimore është barra e provave që parashihet me nenin 7 të LPK-së dhe nenin 23 të Shtojcës së Ligjit me numër 04/L-034. Me nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit me numër 04/L-034 për AKP-në është e përcaktuar e drejta në dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës për shkak të privatizimit të ndërmarrjes. Mirëpo meqenëse parashtruesit të ankesës nuk i është shkëputur marrëdhënia e punës për shkak të privatizimit të ndërmarrjes nuk i takon kompensimi në emër të dëmshpërblimit ngase nuk ka punuar në Ndërmarrje që nga viti 1992. Në lidhje me vendimin gjyqësor me numër 316/95, ka theksuar se ky vendim nuk e parasheh dëmshpërblimin për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Po ashtu ka theksuar se ky vendim është parashkruar në përputhje me nenin 379 të LMD-së, i cili e parasheh se kërkesat që mbështeten në vendime gjyqësore parashkruhen me kalimin e afatit

prej 10 viteve.

Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që ankesën e parashtruar nga R Sh ta refuzoj si të pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit në pajtim me nenin 70.4 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-033.

### Arsyetimi Ligjor

Në bazë të nenit 76 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të Kosovës, gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Pas shqyrtimit të provave të lëndës parashtrimeve dhe pretendimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundimin se ankesa e parashtruar në këtë çështje juridike është e pa bazuar.

Pas shqyrtimit të pretendimeve, parashtrimeve dhe provave të lëndës gjykata ka gjetur se parashtruesi i ankesës me datën 20.04.2017, ka parashtruar një kërkesë pranë Autoritetit të Likuidimit, përmes së cilës ka kërkuar kompensim në emër të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në Ndërmarrje, kompensimit të pagave të pa paguara dhe kontributet pensionale. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga i njëjti në atë procedurë dhe me vendimin me numër PEJ002-0010, të datës 30.05.2017, kërkesën e parashtruar nga R Sh e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar.

Parashtruesi i ankesës në ankesën e parashtruar ka pretenduar se ka qenë punëtor në NSH-së me kontratë të përhershme të punës, ka pretenduar se i takon kompensimi në emër dëmshpërblimit. Në anën tjetër pala kundërshtarë e ka kontestuar ankesën duke thekuar se në rastin konkret parashtruesit të ankesës nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të veprimeve të ndërmarra nga AKP-ja, mirëpo marrëdhënia e punës i është ndërprerë në vitin 1992.

Kompensimi i pagave është e rregulluar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit që evidentohet me numër 04/L-034 për AKP, janë të përcaktuara kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në. Pastaj me nenin 322 paragrafi 1 të LPK-së, është e përcaktuar se “në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës. Po ashtu dhe paragrafin 2 të të njëjtit nen është e përcaktuar se “pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”.

Në rastin konkret gjykata pas shqyrtimit të provave të lëndës ka ardhur në përfundimin se parashtruesi i ankesës nuk ka parashtruar prova të mjaftueshme në lidhje me kërkesën e pretenduar, respektivisht nuk i ka argumentuar pretendimet e dhëna me ankesë, nuk ka

prezantuar letër pezullimin i cili do të dëshmonte se marrëdhënia e punës i është ndërprerë nga AKP-ja, andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e lartë cekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Parashtruesi i ankesës me kërkesën kreditore drejtuar AL-së dhe me ankesën pranë gjykatës ka theksuar se i takon kompensimi në emër të dëmshpërblimit dhe si argument e ka përdorur aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë Pi.nr.316/95, i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 25.11.1996. Ndërsa kërkesën kreditore pranë AL-së e ka parashtruar me datën 20.04.2017, pas kalimit të afatit prej 10 vitesh. Me nenin 379 të LMD-së (së vitit 1978) është e përcaktuar se të gjitha kërkesat që janë përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me anë të pajtimit para gjykatës ose organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë vjet dhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër parashkrimi. Nga zbatimi i dispozitave ligjore të lartpërmendura, rezulton se kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave që bazohen në aktgjykimin e datës 25.11.1996, është parashkruar pas kalimit të afatit prej 10 vitesh, që nga momenti kur aktgjykimi ka marrë formë të prerë.

### Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenin 62 paragrafi 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata vendosi që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale.

### KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari;  
Asllan Krasniqi